

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 3450 Rep

NR. 1273 Kol



KONTRATE SHITJE PJESESH KAPITALI

Sot me date, 11 Tetor 2004, para meje Gjergj Meksi Notere e Dhomes se
Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:

ALEKSANDROS NTOUSIAS, shtetas Grek, lindur në Athine Greqi, më datë 26 Korik
1950, mbajtës i pasaportës nr. T 001261, ne cilesine e ortak te Shoqerise "ARAL"Sh.p.k,
qe zoteron 50% te jeseve te kapitalt te kesaj shoqerie

qe ketu e me poshte do te quhet **Shitesi;**

dhe

ARTA MICI, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 16.06.1949, mbajtëse e
pasaportës nr. 0106602, ne cilesine e ortaktes te shoqerise "ARAL"Sh.p. qe zoteron 50%
te pjeseve te kapitalit.

qe ketu e me poshte do te quhet **Bleresi;**

te cilet ne cilesine e ortakëve te shoqerise me kapital të përbashkët ARAL SHPK, e
regjistruar me Vendimin Nr. 865, datë 5 Janar 1994 të Gjykatës së Shkallës së Parë
Tiranë, me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate:

Neni 1 - Qellimi

Shitesi bie dakord qe t'i shese Blerësit 50 për qind të pjesëve të kapitalit themeltar qe ai
zoteron ne shoqerine ARAL SHPK.

Bleresi pranon te bleje 50 për qind të pjesëve të kapitalit themeltar qe Shitesi zotëron në
shoqerinë ARAL SHPK.

Neni 2 - Pershkrimi

Shitesi eshte ortak i shoqerise ARAL SHPK, shoqeri e organizuar ne baze te ligjeve
shqiptare, e krijuar me 5 Janar me Vendimin nr. 865 te Gjykatës se Shkallës së Parë
Tiranës dhe zoteron 50 për qind te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie.

antusias

Ne perputhje me kete kontrate, Shitësi do t'i transferoje Bleresit nepermjet shitjes, të gjithë pjesët e kapitalit.

Me tjetersimin e 50% te pjeseve te kapitalit nga Shitesi tek Bleresi, ky i fundit behet ortak i vetem i shoqerise duke zoteruar 100% te pjeseve te kapitait duke perfshire ketu te gjitha aktivitetet dhe pasivet e shoqerise.

Neni 3 - Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Shitesi garanton Bleresin se pjesët e kapitali të shoqerise ARAL SHPK jane te transferueshme dhe te lira nga cdo barre.

Neni 4 – Cmimi dhe menyra e pageses

Palet bien dakord qe cmimi i shitjes se 50 për qind të pjesëve të kapitalit themeltar do të jetë 1.492.647 leke (njemilion e katerqindenedhjetedymijeegjashteqindedyzeteeshtate) leke që jane shlyer tersisht nga ana e Bleresit.

Neni 5

Kalimi i pronesise

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Bleresi do te behet menjehere zoterus i 100% te pjeseve te kapitalit. Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate Shitblerjeje, Bleresi eshte i detyruar te beje depozitim e kesaj kontrate prane Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

Neni 6 - Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet qe lindin nga kjo kontrate do te zgjidhen me mirekuptim nga palet, ne rast te kundert do t'i drejtohen Arbitrazhit Tregtar Shqiptar. Per kete qellim palet do te caktojne nje arbter te vetem.

Neni 7 - Te ndryshme

Kjo kontrate i nenshtrohet legjislacionit shqiptar.

Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (tre) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

Une noterja, pasi u binda per identitetin e paleve, ja u lexova me ze te larte permbajtjen e kesaj kontrate dhe pasi ata e nenshkruan ne pranine time, une noterja vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

SHITESI

ALEKSANDROS NTOUSIAS

Alexandros Ntosias

antosias

ALEKSANDRA M. GJONI
PERKTHYESE LEGALE
CEL: 069 2152014

Milla

BLERESI

ARTA MIÇI

Arta Mici

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

Kokoli